

Treguesit e realizimit të  
buxhetit të Bashkisë Tiranë  
për 12-mujorin 2022

## **PËRMBAJTJA**

	<b>HYRJE</b>	<b>Fq.3</b>
<b>KAPITULLI I</b>	<b>Realizimi i të ardhurave të Bashkisë Tiranë për vitin 2022</b>	<b>Fq.4</b>
<b>KAPITULLI II</b>	<b>Realizimi i shpenzimeve të Bashkisë Tiranë për 12 mujorin 2022</b>	<b>Fq.25</b>
	Shpenzimet sipas programeve	Fq.26
	Shpenzimet sipas burimeve të financimit	Fq.27
	Shpenzimet sipas programeve dhe klasifikimit ekonomik	Fq.28
<b>KAPITULLI III</b>	<b>Monitorimi i Shpenzimeve dhe Produkteve sipas programeve</b>	<b>Fq.37</b>
<b>KAPITULLI IV</b>	<b>Ecuria e buxhetit të Bashkisë Tiranë për 12 mujorin e viteve 2018-2022</b>	<b>Fq.76</b>

**RAPORT MONITORIMI**  
**I**  
**BASHKISË TIRANË PËR 12-MUJORIN 2022**

---

**HYRJE**

---

Bazuar në Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2016 për “Vetëqeverisjen Vendore”, ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar), ligjit nr. 68 datë 27.04.2017 “Për Financat e vetëqeverisjes vendore”, Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”; udhëzimit plotësues nr. 2, datë 19.01.2023 të Ministrit të Financave “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023”; Udhëzimit nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të Monitorimit të buxhetit për njësitë e vetëqeverisjes vendore”; VKB nr. 166, datë 24.12.2021 “Për miratimin e PBA 2022-2024 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2022, (i ndryshuar), paraqesim raportin e monitorimit të buxhetit për 12-mujorin 2022, duke analizuar performancën financiare në funksion të arritjes së objektivave dhe realizimit të shpenzimeve sipas programeve.

Raporti bazohet në të dhënat për shpenzimet faktike dhe transfertat ndërqeveritare, duke ndjekur klasifikimin administrativ, ekonomik, funksional dhe sipas burimeve të financimit.

Transparenca mbi përdorimin e fondeve publike është e rëndësishme për përmirësimin e ofrimit të shërbimeve, ndërgjegjësimin dhe aktivizimin e qytetarëve në vendimmarrje, dhe rritjen e përgjegjshmërisë së të zgjedhurve ndaj qytetarëve. Tashmë, që nga viti 2015 zbatohet Reforma Administrative dhe Territoriale (RAT) dhe e decentralizimit të funksioneve të reja.

Në zbatim të nenit 39 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me VKB nr. 18, datë 04.04.2022, të ardhurat e papërdorura të vitit buxhetor 2021 trashëgohen në buxhetin e vitit 2022.

Informacioni i përcjellë në këtë raportim është realizat jo vetëm nga raportet e tërhequra nga SIFQ (Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë) por dhe nga informacioni i përcjellë në mënyrë shkresore nga Drejtoritë e Bashkisë Tiranë dhe Institucionet e Varësisë të përfshira në këtë proces.

Bashkia Tiranë po vijon me likuidimet e angazhimeve të marra dhe ka vijuar evidentimin dhe përfshirjen në buxhet të detyrimeve të prapambetura nga viti 2021 sipas informacioneve të sjella edhe nga strukturat të cilat menaxhojnë funksionet e Bashkisë.

Nga ana tjetër, dinamika me të cilën ecin punët në Bashkinë Tiranë kërkon jo vetëm rishikime të projekteve në vazhdim, por edhe kërkesa për të shtuar projekte dhe shpenzime të reja për të maksimizuar nevojat e institucionit në funksion të qytetit.

# KAPITULLI I

## REALIZIMI I TË ARDHURAVE TË BASHKISË TIRANË PËR VITIN 2022

### Të Ardhurat nga Taksat dhe Tarifat Vendore.

Parashikimi i të ardhurave për Bashkinë e Tiranës është mbështetur mbi llogaritjet e kapacitetit të taksave e tarifave, në aktet ligjore të sistemit fiskal dhe në ecurinë e realizimit në vitet e mëparshme.

Për vitin 2022, plani i të ardhurave është miratuar në shumën 14,407,253,000 lekë.

Në mbyllje të vitit 2022 rezulton se të ardhurat janë realizuar në shumën 18,126,267,975 lekë ose në masën 126 % ndaj planit, nga të cilat:

- të ardhurat tatimore janë realizuar në vlerën 12,160,573,541 lekë
- të ardhura jotatimore janë realizuar në vlerën 5,965,694,434 lekë

Kategoria	Plani 2022	Fakti 2022	%
Të ardhura tatimore	9,721,200,000	12,160,573,541	125%
Të ardhura jo tatimore	4,686,053,000	5,965,694,434	127%
<b>Totali</b>	<b>14,407,253,000</b>	<b>18,126,267,975</b>	<b>126%</b>

Realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore më kryesore të Bashkisë së Tiranës, nëpërmjet një analize edhe për faktorët që kanë ndikuar në këto rezultate për vitin 2022, jepet në vijim.

Strukturat arkëtuese të të ardhurave për Bashkinë Tiranë, janë si më poshtë:

- Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore
- Strukturat e Bashkisë
- Institucionet e varësisë
- Agjentët tatimorë.

### **DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE**

Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, planin vjetor për vitin 2022 për 4,721,200,000 lekë e ka realizuar në masën 4,504,904,734 lekë ose 95%

## A. Taksa mbi ndërtesën

Të dhënat e realizimit 2022, për taksën mbi ndërtesat e subjekteve “familjarë” dhe subjekteve të biznesit paraqitet si më poshtë:

në lekë


Emërtimi	Plani 2022	Fakti 2022	%
Taksa mbi ndërtesën e subjekteve “Familjarë”	670,000,000	638,555,878	95%
Taksa mbi ndërtesën e subjekteve të biznesit	1,970,000,000	1,598,986,567	81%

Gjatë vitit 2022 kjo taksë është më e lartë për kategorinë biznese gjithashtu dhe për kategorinë familjarë krahasuar me vitet e tjera por është më e ulët krahasuar me vitin 2021 duke pasur parasysh se në vitin 2021 janë arkëtuar dhe detyrime të prapambetura të vitit 2020, vit i pandemisë.

në lekë

Taksa mbi ndërtesën	2019	2020	2021	2022
Familjarë	233,353,993	536,606,757	666,341,648	638,555,878
Biznesi	1,605,209,838	1,380,326,027	1,643,669,627	1,598,986,567
<b>Totali</b>	<b>1,838,563,831</b>	<b>1,916,932,784</b>	<b>2,310,011,275</b>	<b>2,237,542,445</b>

Grafikisht:



Nga 1 Prilli i vitit 2018 e në vazhdim ka filluar të mblidhet taksa e ndërtesës në bazë të ndryshimeve që i janë kryer ligjit mbi taksat vendore në bazë të VKM nr.132 datë 07.03.2018 “Për metodologjinë për

përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe kriteret dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës” si dhe kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës” dhe ndryshimeve që i janë kryer kësaj VKM me VKM nr.168 datë 27.03.2019 dhe VKM 144 datë 03.02.2020.

Numri i njësive të pronës aktive të regjistruara për taksën e ndërtesës në lidhje me subjektet e biznesit jepet si më poshtë:

Emërtimi	2019	2020	2021	2022
Individë	29,542	29,972	30,374	30,792
Biznes i madh	4,126	4,457	4,750	5,024
Biznes i vogël	8,684	8,573	8,608	8,687
VIP	1,682	1,734	1,892	1,907
Të tjerë	2,681	2,658	2,624	2,588
<b>Totali</b>	<b>46,715</b>	<b>47,394</b>	<b>48,248</b>	<b>48,998</b>

Në tabelën e mëposhtme janë disa të dhëna për numrin e pronave të tarifuara sipas ndryshimeve ligjore, vlerën e tarifuar, pagesën e kryer në sistem deri më 31.12.2022 të ndara sipas klasifikimeve të aneksit 2 të VKM-së nr.132 datë 07.03.2018, për arkëtimet e kryera vetëm për vitin 2022.

Emërtimi	Njësi tarifuar	Sipërfaqe e tarifuar	Vlera e tarifuar	Pagesa deri 31.12.2022	Numri i Likuiduesve	Sip. Likuiduese
Tregti e shërbime 'a'	47,126	5,158,075	1,843,520,943	1,290,278,495	29,604	3,630,837
Bodrome Parking 'b'	161	81,040	21,137,461	15,253,886	136	64,884
Pika C	19	16,476	1,596,918	331,950	5	4,926
Prodhim, magazinë 'ç'	1,604	1,526,589	178,407,334	159,544,634	1,402	1,374,839
Bujqësi 'd'	41	12,327	877,424	321,256	24	3,997
<b>Totali</b>	<b>48,951</b>	<b>6,794,507</b>	<b>2,045,540,080</b>	<b>1,465,730,221</b>	<b>31,171</b>	<b>5,079,483</b>

Ndërkohë, Ujësjetës Kanalizime Tiranë, bazuar në marrëveshjen e bashkëpunimit me Bashkinë Tiranë, për arkëtimin e taksave dhe tarifave nga kategoria “Familjarë”, çdo muaj përgatit akt rakordimin mbi evidentimin e familjeve likuiduese të detyrimit dhe atyre përfituese të lehtësirave fiskale si dhe vlerën përkatëse që duhet t’i xhirojë Bashkisë Tiranë.

Problematikat në lidhje me të ardhurat e mbledhura nga kjo taksë vazhdojnë të mbeten mos saktësimi i sipërfaqeve reale dhe faturimi i një pjese të abonentëve me sipërfaqe të prezumuar si dhe regjistrimi si abonentë për taksën e ndërtesës për familjet që nuk kanë kontratë me Ujësjetellës Kanalizimin Tiranë sh.a. Njësitë Administrative, të cilat kanë bërë më parë mbledhjen e kësaj takse, nuk disponojnë informacion të saktë për evidentimin e tyre dhe si rrjedhojë për këto familje haset vështirësi për njoftim nga UKT sh.a, për detyrimin që kanë ndaj Bashkisë së Tiranës.

## **B. Taksa mbi tokën bujqësore**

Të dhënat e realizimit për vitin 2022 për taksën mbi tokën bujqësore nga të gjitha kategoritë disponuese të tokës, paraqitet si më poshtë:

në lekë

Emërtimi	Plani 2022	Fakti 2022	%
Taksa mbi tokën Bujqësore	31,000,000	23,431,924	76%

Ndër problemet kryesore të hasura prej vitesh në lidhje me të ardhurat nga kjo taksë, vijon të jetë mungesa e bazës së të dhënave prej regjistrave të tokës bujqësore nga Njësitë Administrative (ish-Komunat).

Fakti i diferencës së njësive aktive me ato likuiduese tregon për mosazhurnim të situatës në terren dhe pamundësinë e ndjekjes të njësive mospaguese për detyrimin e kësaj takse.

Kategoria e tokës	Njësi Aktive të Tarifuara	Njësi Likuiduese	Sip. Aktive të tarifuara	Sip. Likuiduese
Kategoria I	2,994	1,709	837	979
Kategoria II	6	4	1	2
Kategoria III	1,617	658	1,010	791
Kategoria IV	1,672	746	901	730
Kategoria V	4,988	1,751	3,117	2,011
Kategoria VI	4,489	1,338	3,485	2,027
Kategoria VII-X	3,061	619	1,705	586
<b>Totali</b>	<b>18,827</b>	<b>6,825</b>	<b>11,057</b>	<b>7,126</b>

Problemet kryesore të hasura këto vitet e fundit në lidhje me këtë taksë janë:

- Mungon informacion i plotë për ngastrat e tokës bujqësore nga NJA;
- Regjistrimet e kryera nga inspektorët e terrenit në disa ish-komuna kanë mangësi për emrat, sipërfaqet dhe kategoritë.
- Ndryshime në llojin e tokës, raste kur me dokumenta figuron tokë bujqësore dhe në fakt është kthyer në truall.

Krahasimi i realizimit ndër vite është si më poshtë:

në lekë

Emërtimi	2019	2020	2021	2022
Taksa mbi tokën bujqësore	20,299,189	21,207,054	22,183,650	23,431,924

### C. Taksa mbi truallin

Taksa mbi truallin, ka të bëjë me truallin e përdorur për banesë dhe për biznes. Të ardhurat nga kjo taksë për vitin 2022, janë realizuar në shumën 85,213,072 lekë, kundrejt planit 65,000,000 lekë, pra kemi një realizim prej 131%.

Të dhënat e realizimit për vitin 2022, për taksën mbi truallin, paraqiten si më poshtë:

në lekë

Emërtimi	Plani 2022	Fakti 2022	%
Taksa e Truallit	65,000,000	85,213,072	131%

Struktura përgjegjëse për arkëtimin e taksës mbi truallin është DPTTV në bashkëpunim me Njësitë Administrative. Të ardhurat nga kjo taksë kanë patur një realizim të mirë krahasuar me planifikimin duke arritur dhe një realizim në 131%.

Realizimi i të ardhurave nga kjo taksë mbështetet tek evidentimi i njësive aktive dhe njësive likuiduese, të cilat për vitin 2022, paraqiten si më poshtë:

Lloji i truallit	Njësi Aktive Tarifuar	Njësi Likuiduese	Sip. Aktive Tarifuar	Sip. Likuiduese
Taksa mbi truallin - Truall për qëllime banimi	2,107	529	796,042	327,025
Taksa mbi truallin - Truall për qëllime biznesi	2,791	1,996	3,940,859	3,177,146
<b>Total</b>	<b>4,898</b>	<b>2,525</b>	<b>4,736,901</b>	<b>3,504,171</b>

Problemet e konstatuara gjatë vitit 2022, janë:

- Mungesa e informacionit të plotë mbi pronësinë e truallit, në territorin e Bashkisë Tiranë.
- Mungesa e bashkëpunimit me struktura që disponojnë informacion mbi këtë formë pasurie por dhe pamundësia e azhurnimit të informacionit në terren.


Krahasimi i realizimit ndër vite është si më poshtë:

në lekë

Emërtimi	2019	2020	2021	2022
Taksa e Truallit	56,079,090	50,714,059	65,136,671	85,213,072

Grafikisht të dhënat e mësipërme të realizimit në vite:





#### D. Taksa e fjetjes në hotel

Taksa e fjetjes në hotel është një detyrim mujor që evidentohet çdo fund-muaji nga pagesat e njësisve akomoduese.

Gjatë vitit 2022, janë evidentuar gjithsej 330 njësi hotelerie.

Për vitin 2022, janë realizuar të ardhura në shumën 111,515,607 lekë kundrejt planit për 65,000,000 lekë.


Emërtimi	Plani 2022	Fakti 2022	%
Taksa e fjetjes në hotel	65,000,000	111,515,607	172%

Realizimin mbi planin e vitit 2022 dhe më të lartë se vitit paraardhës 2021 tregon se ky sektor i është rikthyer aktivitetit normal te periudhës para pandemisë.

Realizimi i taksës së fjetjes në hotel për 4 vitet e fundit është paraqitur më poshtë:

Emërtimi	2019	2020	2021	2022
Taksa e fjetjes në Hotel	113,966,275	35,815,582	67,226,382	111,515,607

Grafikisht paraqitur më poshtë realizimi i taksës së fjetjes në hotel:



#### E. Taksa e tabelës

Taksa e tabelës aplikohet mbi llojet e tabelave të mëposhtme:

- Tabelë për qëllime identifikim/sinjalizimi;
- Tabelë për qëllime identifikimi deri 2 m<sup>2</sup>, 2-10 m<sup>2</sup>, 10-20 m<sup>2</sup>, 20-40 m<sup>2</sup>, mbi 40 m<sup>2</sup>
- Tabelë për qëllime reklamimi;
- Tabela për qëllime identifikim/sinjalizimi vendoset jashtë territorit të aktivitetit të biznesi për të orientuar blerësit për vendndodhjen e biznesit, me sipërfaqe nën 2 m<sup>2</sup>.
- Tabela për qëllime identifikimi deri 2 m<sup>2</sup>, 2-10 m<sup>2</sup>, 10-20 m<sup>2</sup>, 20-40 m<sup>2</sup>, mbi 40 m<sup>2</sup> janë tabelat e trupëzuara ose jo brenda territorit ku zhvillohet aktiviteti i biznesit dhe që nuk përdoret për të reklamuar veprimtaritë e të tretëve (ku shënohet emri dhe /ose aktiviteti i biznesit)
- Tabelat për qëllime reklamimi e lëvizshme apo e palëvizshme deri në tavanin maksimal 35 m<sup>2</sup>.

Gjatë vitit 2022, janë evidentuar njësitë aktive të tarifuara dhe njësitë, të cilat kanë kryer likuidimin e detyrimit të taksës së tabelës si më poshtë:

Emërtimi	Njësi aktive të tarifuara	Njësi likuiduese	Sipërfaqe aktive të tarifuara	Sipërfaqja likuiduese
Për qëllime identifikimi deri në 2m	2,075	1,236	6,962	271,615,232

Reklamimi të thjeshtë	73	46	571	553
Elektronike	44	20	371	344
<b>Totali</b>	<b>2,192</b>	<b>1,302</b>	<b>7,904</b>	<b>271,616,129</b>

Gjatë vitit 2022 janë arkëtuar gjithsej 296,186,327 lekë ndaj planit prej 300,200,000 lekë.

në lekë

Emërtimi	Plani 2022	Fakti 2022	%
Tabelë identifikuese/sinjalizuese	200,000	73,269	37%
Tabelë reklamuese	300,000,000	296,113,058	99%
<b>Totali</b>	<b>300,200,000</b>	<b>296,186,327</b>	<b>99%</b>


Për vitin 2022, realizimi i të ardhurave nga kjo taksë, ka pësuar rritje në krahasim me vitin e kaluar duke iu afruar sërish niveleve të mëparshme, për faktin që një pjesë e aktiviteteve reklamojnë biznesin në diskoteka, klube nate, pishina dhe komplekse sportive, janë kthyer në aktivitet normal.

Ecuria e taksës së tabelës ndër vite pasqyrohet si më poshtë:

në lekë

Emërtimi	2019	2020	2021	2022
Tabelë	180,634	78,523	80,618	73,269
Reklamë	268,022,505	236,136,356	260,033,125	296,113,058
<b>Totali</b>	<b>268,203,139</b>	<b>236,214,879</b>	<b>260,113,743</b>	<b>296,186,327</b>

Grafikisht realizimi i taksës së tabelës dhe reklamës në vite paraqitet më poshtë:



## F. Taksa e përkohshme e infrastrukturës arsimore

Taksa e përkohshme e infrastrukturës arsimore është një taksë e përkohshme për një periudhë 7-vjeçare. Të ardhurat e mbledhura nga kjo taksë për vitin 2022 janë në masën 94% ndaj planit. Vërejmë që kjo taksë në vitin 2022 ka arritur një nivel të lartë të realizimit që nga momenti i aplikimit.

në lekë

Emërtimi	Plani 2022	Fakti 2022	%
Taksa e përkohshme për infrastrukturën arsimore	810,000,000	759,519,645	94%

Gjeni të paraqitur më në detaj, sipas dy nëndarjeve të mëdha për subjektet "Familjarë" dhe subjektet "Biznesi" realizimin e të ardhurave kundrejt planit për vitin 2022 si me poshtë:

në lekë

Emërtimi	Plani 2022	Fakti 2022	%
Taksa e përkohshme për infrastrukturën arsimore subjektet "Familjarë"	320,000,000	310,870,137	97%

në lekë

Emërtimi	Plani 2022	Fakti 2022	%
Taksa e përkohshme për infrastrukturën arsimore subjektet "Biznesi"	490,000,000	448,649,508	92%

Në tabelë më poshtë pasqyrohen njësitë aktive të tarifuara, detyrimi respektiv vjetor, njësitë likuiduese dhe vlera e likuiduar për vitin 2022:

TPIA	Nj.të tarifuara	Detyrimi vjetor	Nj.likuiduese	Vlera e likuiduar
Biznesi	68,318	490,000,000	50,736	448,649,508

Krahas Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore që ndjek dhe arkëton taksën e përkohshme nga infrastruktura arsimore nga kategoria "Biznes", për kategorinë "Familjarë" rolin e agjentit tatimor e kryen Ujësjetllës-Kanalizime Tiranë sh.a i cili faturon dhe arkëton detyrimin e kësaj takse.

Gjatë vitit 2022, nga Ujësjetllës-Kanalizime Tiranë sh.a është arkëtuar vlera prej 310,870,137 lekë nga kjo taksë, e cila ka kaluar në favor të Bashkisë Tiranë për çdo muaj pas arkëtimit.

Realizimi ndër vite i taksës së përkohshme për infrastrukturën arsimore paraqitet si më poshtë:

në lekë

Taksa e përkohshme për infrastrukturën Arsimore	2019	2020	2021	2022
Familjarë	274,551,161	288,293,159	322,772,232	310,870,137
Biznesi	425,221,988	361,099,635	434,195,046	448,649,508
<b>Totali</b>	<b>699,773,149</b>	<b>649,392,794</b>	<b>756,967,278</b>	<b>759,519,645</b>

### G. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja.

Struktura e ngarkuar për këtë taksë është Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, e cila ndërkohë pranon kërkesat, i shqyrton ato dhe pas miratimit nga Titullari, bën zbardhjen e lejes kundrejt arkëtimit të vlerës së taksës në masën e llogaritur. Të ardhurat nga kjo taksë për vitin 2022 janë realizuar në masën 154% kundrejt planit të miratuar.

në lekë


Emërtimi	Plani 2022	Fakti 2022	%
Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	4,800,000,000	7,414,035,966	154%

Viti 2022 rezulton përsëri vit i suksesshëm për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja, duke arritur vlerën më të lartë të arkëtuar ndër vite si më poshtë:

në lekë

Emërtimi	2019	2020	2021	2022
Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	6,315,307,289	6,350,959,457	7,438,141,907	7,414,035,966

Grafikisht realizimi ndër vite paraqitet si më poshtë:



## TARIFAT

### H. Tarifa e Pastrimit.

Tarifës së pastrimit i nënshtrohen të gjithë familjet, personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që banojnë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë së Tiranës.

Nga të dhënat bazuar në arkëtimet shihet se të ardhurat janë realizuar në masën 103% për subjektet e biznesit.

në lekë

Emërtimi	Plani 2022	Fakti 2022	%
Tarifa e pastrimit nga subjektet "Biznesi"	1,500,000,000	1,538,436,158	103%

Tarifa e pastrimit për kategorinë "Familjarë", për vitin 2022 është realizuar në masën 93%.

Vlen të theksohet se gjatë vitit 2022 janë arkëtuar rregullisht detyrimet për tarifën e pastrimit nëpërmjet faturës së ujit. Numri mesatar i familjeve likujduese 135,092 familje.

në lekë


Emërtimi	Plani 2022	Fakti 2022	%
Tarifa e pastrimit nga subjektet "Familjarë"	815,424,000	761,759,858	93%

Ecuria e arkëtimet të tarifës së pastrimit për të dyja kategoritë si Biznese dhe Familjarë është në trend rritës krahasuar me vitet e mëparshme si rezultat i angazhimit më të madh të strukturave menaxhuese dhe ndikimit në arkëtim të kësaj tarife nga rritja e subjekteve që kanë ndërtuar gjatë vitit 2022.

në lekë

Tarifa e pastrimit	2019	2020	2021	2022
Familjarë	651,984,449	726,552,679	790,364,210	761,759,858
Biznesi	1,138,546,202	1,215,758,389	1,448,405,768	1,538,436,158
Total	1,790,530,651	1,942,311,068	2,238,769,978	2,300,196,016

Grafikisht të ardhurat e realizuara për katër vitet e fundit paraqiten si më poshtë:



#### I. Tarifa për zënien e hapësirave publike.

Baza e tarifës për zënie të hapësirave publike është sipërfaqja në m<sup>2</sup> e cila vihet në shfrytëzim nga individë dhe subjekte për qëllime biznesi.

Tarifa për zënien e hapësirave publike përbëhet nga:

- Zënia e hapësirës publike me kangjella, platforma, vazo etj.
- Zënia e hapësirës publike ne tregjet publike.

Taksa për zënien e hapësirës publike me kangjella, platforma, vazo etj faturohet dhe arkëtohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me njësitë administrative dhe lagjet e Bashkisë Tiranë, për çdo rast të përdorimit të hapësirave publike kundrejt një takse mujore sipas ndarjes zonale të miratuar me nivele që vijnë duke u ulur me largimin nga qendra, nga 1,500 leke/m<sup>2</sup>/muaj deri ne 200 leke/m<sup>2</sup>/muaj.

Të ardhurat nga tarifa për zënien e hapësirave publike për vitin 2022 janë në vlerën 346,830,117 lekë.

në lekë

Emërtimi	Plani 2022	Fakti 2022	%
Tarifa për zënien e hapësirave publike me platforma betoni, kangjella	280,000,000	329,942,005	118%
Tarifa për zënien e hapësirës publike	20,000,000	16,888,112	84%
<b>Totali</b>	<b>300,000,000</b>	<b>346,830,117</b>	<b>116%</b>


Pjesa më e madhe e të ardhurave të gjeneruara nga tarifa për zënien e hapësirës publike është përqëndruar tek Tarifa për zënien e hapësirës publike me platforma, kangjella etj.

Arkëtimet nga tarifa e zënies së hapësirës publike nga viti 2019 deri në vitin 2022 jepen si më poshtë:

në lekë

Emërtimi	2019	2020	2021	2022
Tarifa për zënien e hapësirave publike	385,666,800	223,680,468	276,055,695	346,830,117

Grafikisht të ardhurat e gjeneruara nga tarifa e zënies së hapësirës publike në këto vite paraqiten si më poshtë:



Probleme të konstatuara, janë:

- Mosdeklarimi i saktë i sipërfaqeve në përdorim nga ana e subjekteve;
- Mosazhornimi i saktë i sipërfaqeve në përdorim për mosangazhimin e duhur nga strukturat e ngarkuara;

#### **J. Tarifa për shqyrtimin e kërkesës për leje për punime.**

Tarifa për shqyrtimin e kërkesës për leje për punime paguhet në masën 1% të vlerës së investimit për aplikim për leje ndërtimi dhe 10 lekë për m<sup>2</sup> për sipërfaqe zhvillimi sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për planifikimin e territorit.

Vlera e planifikuar për t'u arkëtuar gjatë vitit 2022 ishte 432,000,000 lekë e cila u realizua në masën 75 % ose 324,432,169 lekë. Ulja e vlerës së realizuar për këtë tarifë vjen nga aplikimi i kësaj tarife vetëm për një aplikim në lidhje me një leje ndërtimi.



në lekë


Emërtimi	Plani 2022	Fakti 2022	%
Tarifa për shqyrtimin e kërkesës për leje për punime	432,000,000	324,432,169	75%

Realizimi i kësaj tarife ndër vite paraqiten si më poshtë:

në lekë

Emërtimi	2019	2020	2021	2022
Tarifa për shqyrtimin e kërkesës për leje për punime	477,529,142	594,764,275	664,327,871	324,432,169

Grafikisht ecuria e kësaj tarife për vitet 2019-2022 paraqitet si më poshtë:



## TIRANA PARKING

### **K. Tarifa e parkimit.**

Tarifa për parkimin e automjeteve në vendparkime publike përfaqëson pagesën e shërbimit që ofron Bashkia e Tiranës për vendqëndrime të mjeteve kundrejt biletës, vendqëndrime të rezervuara dhe vendqëndrime për taksitë e liçensuara.

Për vitin 2022, arkëtimet nga tarifat e parkimit sipas natyrës së tarifimit të parkimit krahasuar me planin vjetor, janë realizuar si më poshtë:

në lekë


Emërtimi	Plani 2022	Fakti 2022	%
Parkim me kontratë	156,400,000	147,708,064	94%
Parkim me bileta	418,202,850	341,917,117	82%
Në sheshe	261,018,396	248,984,610	95%
SMS- Parking	157,184,454	133,932,507	85%
<b>Totali</b>	<b>574,602,850</b>	<b>530,625,181</b>	<b>92%</b>

Krahasuar me vitet e kaluara, arkëtimi i tarifës së parkimit për vitin 2022 ka qënë më i lartë se vitet e tjera për shkak të shtimit të strukturave, vendparkimi i kopshtit Zoologjik.

në lekë

Emërtimi	2019	2020	2021	2022
Tarifa e parkimit	469,401,688	400,015,660	498,689,407	530,625,181

Grafikisht realizimi i tarifës së parkimit për vitet 2019-2022 paraqitet si më poshtë:



## INSTITUCIONE TË TJERA

### **DREJTORIA TATIMORE RAJONALE TIRANË**

#### **L. Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël.**

Duke nisur nga viti 2022 bizneset që realizojnë gjatë vitit një qarkullim deri në 14,000,000 (katërmbëdhjetë milionë) lekë, do ta kenë shkallën tatimore mbi fitimin është 0 (zero).

Struktura e ngarkuar për vjeljen e kësaj takse vendore deri në momentin e aplikimit të saj është Drejtoria

e Përgjithshme e Tatimeve me të cilën Sektori i Agjenteve tatimorë pranë DPTTV, çdo muaj kryen rakordimin e të ardhurave të realizuara.

Për vitin 2022 nuk u parashikua plan për të ardhurat nga ky tatim dhe realizimi ka lidhje me pagesën e detyrimeve të prapambetura të viteve të mëparshme.

Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave nga ky tatim për vitin 2022, paraqitet si më poshtë:

në lekë

Emërtimi	Plani 2022	Fakti 2022
Tatimi i Thjeshtuar mbi Fitimin për Biznesin e Vogël	0	29,022,177

Evidentimi i arkëtimeve të TTHF e BV për çdo muaj të vitit 2022, paraqitet si më poshtë:

në lekë

Periudha	Total Akt rakordimi	Bashkia Tiranë (99%)	Dr. Tatimeve 1%
Akt Rakordimi Nr.12 dt.12.01.2022 për periudhën 01/12 - 31/12/2022	4,907,472	4,858,397	49,075
Akt Rakordimi Nr.1 dt.08.02.2022 për periudhën 01/01 - 31/01/2022	2,632,163	2,605,841	26,322
Akt Rakordimi Nr.2 dt.04.03.2022 për periudhën 01/02 - 28/02/2022	3,528,844	3,493,556	35,288
Akt Rakordimi Nr.3 dt.05.04.2022 për periudhën 01/03 - 31/03/2022	3,004,438	2,974,394	30,044
Akt Rakordimi Nr.4 dt.09.05.2022 për periudhën 01/04 - 30/04/2022	2,689,271	2,662,378	26,893
Akt Rakordimi Nr.5 dt.08.06.2022 për periudhën 01/05 - 31/05/2022	2,566,553	2,540,887	25,666
Akt Rakordimi Nr.6 dt.07.07.2022 për periudhën 01/06 - 30/06/2022	1,224,039	1,211,799	12,240
Akt Rakordimi Nr.7 dt.04.08.2022 për periudhën 01/07 - 31/07/2022	2,606,967	2,580,897	26,070
Akt Rakordimi Nr.8 dt.09.09.2022 për periudhën 01/08 - 31/08/2022	1,604,779	1,588,731	16,048
Akt Rakordimi Nr.9 dt.05.10.2022 për periudhën 01/09 - 30/09/2022	1,759,126	1,741,535	17,591
Akt Rakordimi Nr.10 dt.04.11.2022 për periudhën 01/10 - 31/10/2022	1,136,632	1,125,266	11,366
Akt Rakordimi Nr.11 dt.13.12.2022 për periudhën 01/11 - 30/11/2022	1,361,893	1,348,274	13,619
<b>Totali</b>	<b>29,022,177</b>	<b>28,731,955</b>	<b>290,222</b>

Kalimi i 1% që përfaqëson vlerën e agentit tatimor, (DPT) ekzekutohet vetëm pas miratimit me vendim të Këshillit Bashkiak, si përdorim të ardhurash.

Ecuria ndër vite e këtij tatimi paraqitet si vijon:

në lekë

Emërtimi	2019	2020	2021	2022
Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e BV	171,559,116	206,546,516	230,422,386	29,022,177

## AGJENCIA E KADASTRËS SHETËRORE

### M. Taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e kësaj takse është Agjencia e Kadastrës Shtetërore. Nga rakordimet e bëra me këtë Agjenci nga Sektori i Agjentëve Tatimorë, realizimi i të ardhurave nga taksa e kalimit të pronësisë për vitin 2022, është 135% e planit vjetor siç shihet edhe në tabelën e mëposhtme:

në lekë

Emërtimi	Plani 2022	Fakti 2022	%
Taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme	400,000,000	538,304,919	135%


Ecuria për vitet 2019-2022 e kësaj takse paraqitet si vijon:

në lekë

Emërtimi	2019	2020	2021	2022
Taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme	326,363,132	365,273,593	445,977,729	538,304,919

Grafikisht realizimi i kësaj takse paraqitet si më poshtë:

## Taksa e kalimin të së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme



### DREJTORIA RAJONALE E SHËRBIMIT TË TRANSPORTIT RRUGOR

#### N. Taksa vjetore e mjeteve të përdorura

Agjenti tatimor i kësaj takse është Drejtoria Rajonale e Shërbimit të Transportit Rrugor e cila çdo muaj krahas kontrollit teknik, realizon edhe arkëtimin e taksës vjetore të mjeteve të përdorura nga e cila i kalon Bashkisë 18% të shumës së arkëtuar, pasi ka zbritur 5%, si komision të përfituar si agjent tatimor. Sipas akt rakordimeve mujore të përgatitura nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave Vendore dhe Drejtoria Rajonale e Shërbimit të Transportit Rrugor, rezulton se krahas të ardhurave të arkëtuara nga taksa vjetore e mjeteve të përdorura është evidentuar dhe numri i mjeteve që kanë likuiduar këtë taksë, si më poshtë:

Muaji	Nr. mjeteve	Vlera e arkëtuar dhe kaluar për Bashkinë Tiranë
Dhjetori 2021	21,663	75,835,178
Janar	11,100	36,155,140
Shkurt	10,360	31,072,214
Mars	8,708	24,602,386
Prill	9,182	24,205,525
Maj	14,173	38,557,766
Qershor	17,581	49,354,483
Korrik	16,861	48,511,483
Gusht	16,077	45,301,920
Shtator	13,396	38,342,711

Tetor	13,938	39,513,462
Nentor	13,467	39,104,177
<b>Totali</b>	<b>166,506</b>	<b>490,556,445</b>

Realizimi i të ardhurave nga taksa e mjeteve të përdorura për vitin 2022 është në masën 117%, ashtu siç paraqitet edhe në tabelën e mëposhtme:

në lekë

Emërtimi	Plani 2022	Fakti 2022	%
Taksa vjetore e mjeteve të përdorura	420,000,000	490,556,445	117%

Ecuria ndër vite e kësaj takse paraqitet si vijon:

në lekë

Emërtimi	2019	2020	2021	2022
Taksa vjetore e mjeteve të përdorura	433,146,135	442,712,995	466,305,347	490,556,445

Grafikisht realizimi i kësaj takse paraqitet si më poshtë:



**TË ARDHURA NGA DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ÇERDHEVE DHE KOPSHTEVE DHE KONVIKTET**

Për fëmijët që frekuentojnë kopshtet dhe çerdhet paguhet tarifa mujore, e cila llogaritet nga tarifa ditore për ushqimin dhe ditët e frekuentimit të fëmijës gjatë muajit.

Realizimi i arkëtimit të ketyre pagesave, për vitin 2022, është si më poshtë:

në lekë

Emërtimi	Plani 2022	Fakti 2022	%
Të ardhurat nga Kopshtet	152,384,000	156,159,803	102%
Të ardhurat nga Çerdhet	80,152,000	85,353,791	106%
Të ardhurat nga Konviktet	4,200,000	9,745,085	232%

Investimet e kryera nga Bashkia Tiranë në drejtim të përmirësimit të kushteve por dhe në rritjen e kapaciteteve në kopshtet e çerdhet e Tiranës janë reflektuar edhe në rritjen e ndjeshme të frekuentimit të fëmijëve në këto institucione për pasojë edhe në rritjen e të ardhurave prej tyre.

Mbetet akoma punë për rritjen e kapaciteteve për këto institucione që diktohet nga kërkesat e pafundme të prindërve që kërkojnë regjistrimin e fëmijëve të tyre për frekuentimin në kopshtet e çerdhet publike, falë kushteve të mira për mirërritjen e fëmijëve por dhe konkruense me subjektet private që aplikojnë kosto të larta.

Viti 2022 ka pasur një rritje të të ardhurave të mbledhura nga këto aktivitete si pasojë e rikthimit në normalitet të frekuentimit të ketyre strukturave.

Ecuria ndër vite e këtyre të ardhurave paraqitet si vijon:

në lekë

Emërtimi	2019	2020	2021	2022
Të ardhura nga Kopshtet	128,533,229	89,124,960	138,846,520	156,159,803
Të ardhura nga Çerdhet	74,912,390	50,759,970	78,146,033	85,353,791
Të ardhurat nga Konviktet	6,103,881	4,572,310	4,777,298	9,745,085

# KAPITULLI II

## REALIZIMI

### I

#### SHPENZIMEVE TË BASHKISË TIRANË PËR 12-MUJORIN 2022

Bashkia Tiranë, gjatë kësaj periudhe, ka menaxhuar dhe realizuar shpenzime sipas 34 programeve buxhetore, Fondit Rezervë dhe Fondit të Kontigjencës, bazuar në funksionet bazë dhe të deleguara sipas ligjit për qeverisjen vendore, konkretisht:

1. Programi Planifikim, Menaxhim & Administrim
2. Programi Çështje Financiare & Fiskale
3. Programi Gjëndja Civile
4. Programi Shërbimet e Policisë Vendore
5. Programi Mbrojtja nga Zjarri & Mbrojtja Civile
6. Programi Mbështetja për Zhvillimin Ekonomik
7. Programi Shërbimi i Tregjeve, Akreditimi & Inspektimi
8. Programi Shërbimet Bujqësore, Inspektimi, Siguria Ushqimore & Mbrojtja e Konsumatorëve
9. Programi Menaxhim i Infrastrukturës së Ujitjes & Kullimit
10. Programi Administrimi i Pyjeve & Kullotave
11. Programi Rrjeti Rrugor
12. Programi Transporti Publik
13. Programi Projekte Zhvillimi
14. Programi Zhvillimi i Turizmit
15. Programi Menaxhim i Mbetjeve
16. Programi Programet e Mbrojtjes së Mjedisit
17. Programi Planifikim Urban Vendor
18. Programi Strehimi
19. Programi Programet e Zhvillimit
20. Programi Menaxhimi i Mbetjeve Urbane
21. Programi Shërbimet Publike Vendore
22. Programi Ndriçim Rrugësh
23. Programi Sport dhe Argëtim
24. Programi Trashëgimia Kulturore, Eventet Artistike & Kulturore
25. Programi Arti dhe Kultura
26. Programi Arsimit Bazë përfshirë arsimin parashkollor
27. Programi Arsimit i Mesëm i Përgjithshëm
28. Programi Arsimit Profesional
29. Programi Arsimit Universitar
30. Programi Kujdesi Social për personat e sëmurë & me aftësi të kufizuara
31. Programi Kujdesi Social për familjet & fëmijët
32. Programi Papunësia, Arsim & Aftësim Profesional
33. Programi Strehim Social
34. Programi Emergjencë Civile
35. Fondi Rezervë



## 36. Fondi i Kontigjencës

Buxheti fillestar i Bashkisë Tiranë për vitin 2022 është 23,608,964,061 lekë. Kjo vlerë përfshin të Ardhurat e veta të Bashkisë Tiranë, Transfertën e Pakushtëzuar e Përgjithshme dhe Sektoriale, dhe Donatorët.

Gjatë vitit 2022 kemi pasur rishikim të buxhetit me 18 (tetëmbëdhjetë) Vendime të Këshillit Bashkiak dhe 4 (katër) Urdhëra Kryetari.

Referuar akt-rakordimeve përfundimtare, fondi i mbartur në total është në vlerën 5,274,288,403 lekë, i përbërë: nga të ardhurat e mbartura dhe të papërdorura në shumën 3,606,092,031 lekë; nga transfertat e pakushtëzuar sektoriale e përgjithshme në shumën 1,643,211,738 lekë dhe nga donatorët në shumën 24,984,634 lekë.

Referuar Akt-rakordimit përfundimtar të fondit të rindërtimit, vlera e mbartur është 5,349,010,561 lekë.


### 1. Çështje të rishpërndarjes së buxhetit gjatë periudhës

- Përfshirja e kërkesave dhe e detyrimeve të krijuara rishtazi në buxhetin e vitit 2022, për Aparatin e Bashkisë si dhe për të gjitha institucionet e varësisë së Bashkisë së Tiranës, si dhe sistemime në zërat e investimeve duke sjellë si rezultat shtesa, pakësime apo rishpërndarje fondesh si rezultat i dinamikës pas hapjes nga periudha e pandemisë.
- Fondet e trashëguara të rindërtimit nga viti 2021 përdoren për të njëjtin qëllim për të cilin janë akorduar bazuar në VKM-të e vitit 2022, si rindërtimi i objekteve arsimore, rindërtimi i banesave individuale, rindërtimi i infrastrukturës publike, rindërtimi i njësive të banimit ndërtesa (pallat) zona 5 Maji Kombinat, hartim i planeve të detajuara vendore, inspektim vlerësim dëmsh, hartim projekti të ndërhyrjeve rehabilituese, si dhe shpronësimi, zhvillimi i Njësive Administrative Vaqarr dhe Zall-Herr.
- Nga Drejtoritë e Përgjithshme janë paraqitur kërkesa për rialokime në buxhetin e vitit 2022 kryesisht në shtim plani për shpenzime operative, ndryshime emërtimesh, investime të reja, studim-projektme dhe oponenca për objekte të reja ndërtimore, etj.
- Fond shtesë për rindërtimin për vitin 2022, akorduar në formën e transfertës së pakushtëzuar për financimin e riorcimit të njësive individuale të banimit dhe njësive të banimit në ndërtesa (pallat) në Bashkinë Tiranë.
- Gjatë vitit janë asistuar disa mbështetje financiare, të cilat janë: Mbështetje financiare në kuadër të aktivitetit ndërkombëtar Europa Conference League Final për Federatën Shqiptare të Futbollit; Mbështetje financiare për familjarët e anëtares së Këshillit Bashkiak Tiranë Znj Dorina Kuka; Mbështetje financiare për Shoqëritë “Rezidenca Studentore Universitare Nr.1 dhe “Rezidenca Studentore Universitare Nr.2”; Mbështetje financiare në formën e huasë për ndërmarrjen “Qendra Sportive Tirana”, në varësi të Bashkisë Tiranë.

- Kompensimi i biletës së pajtimit mujor të përgjithshëm (Abonesë së Studentit) për studentët e pajisur me kartë studenti, në transportin qytetës në Bashkinë e Tiranës për periudhën Nëntor 2022 - Shtator 2023. Pajisja e studentëve me Abone Studenti bëhet falas.
- Miratimi i marrëveshjes së bashkëpunimit midis Bashkisë Tiranë dhe Kongresit Rinor Kombëtar për financimin dhe zbatimin e programit “Tirana Youth Capital 2022” dhe manualit të tij. Për shkak të impaktit të madh kombëtar dhe ndërkombëtar që ky titull ka pasur dhe vijon të ketë është akorduar një fond shtesë.

## 2. Shpenzimet sipas programeve

Buxheti i planifikuar për vitin 2022 i Bashkisë Tiranë i ndarë sipas programeve paraqitet si vijon:



Siç vihet re, peshën më të madhe në planifikim e zënë:

- Programi i Shërbimeve Publike Vendore (12%)
- Programi i Arsimit Bazë përfshirë Arsimin Parashkollor (11%)
- Programi i Panifikimit Urban Vendor (8%)
- Programi i Rrjetit Rrugor (7%)
- Programi i Planifikim, Menaxhim dhe Administrimit (7%)
- Programet e Zhvillimit (16%)

- Programi i Kujdesit Social për familjet dhe fëmijët (7%)
- Programi i Menaxhimit të Mbetjeve (5%)
- Programi Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm (4%)
- Programet e Tjera (23%)

### 3. Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik

Në total, Bashkia Tiranë ka një realizim prej 70% të planit 12-mujor 2022. Kjo vlerë përfshin të gjitha burimet e financimit.

Referuar klasifikimit ekonomik, realizimi paraqitet si më poshtë:

- Shpenzimet e personelit janë realizuar me 90%,
- Shpenzimet operative me 85% dhe
- Shpenzimet kapitale me 54%.

Më poshtë paraqitet në mënyrë tabelare informacioni i mësipërm:

në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2022	Plani 12M 2022	Fakti 12M 2022	Realizimi në %
<i>Shpenzime personeli</i>	6,873,685,972	6,873,685,972	6,164,000,889	90%
<i>Shpenzime të tjera operative</i>	15,450,457,848	15,450,457,848	13,192,178,196	85%
<i>Shpenzime kapitale</i>	23,626,781,891	23,626,781,891	12,755,057,190	54%
<b>Totali</b>	<b>45,950,925,711</b>	<b>45,950,925,711</b>	<b>32,111,236,275</b>	<b>70%</b>


### 4. Shpenzimet sipas burimeve të financimit

Shpenzimet sipas burimeve të financimit për 12-mujor 2022, paraqiten si më poshtë:

në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2022	Plani 12M 2022	Fakti 12M 2022	Realizimi në %	struktura vjetore
<i>Të ardhura BT</i>	23,413,728,404	23,413,728,404	13,458,513,212	57%	51%
<i>Transferta e Pakushtëzuar +Sektoriale</i>	5,466,205,539	5,466,205,539	4,335,766,688	79%	12%
<i>Transferta e Pakushtëzuar Rindertimi</i>	11,228,702,017	11,228,702,017	9,382,668,805	84%	24%
<i>Transferta e Kushtëzuar</i>	5,614,616,062	5,614,616,062	4,910,940,791	87%	12%
<i>Donacione</i>	40,288,591	40,288,591	14,038,595	35%	0%
<i>Financime tëHuaja</i>	159,129,121	159,129,121	-	0%	0%
<i>TVSH Detyrimi</i>	28,255,977	28,255,977	9,308,185	33%	0%
<b>Totali</b>	<b>45,950,925,711</b>	<b>45,950,925,711</b>	<b>32,111,236,275</b>	<b>70%</b>	<b>100%</b>

Sikurse vërehet edhe në tabelën e mësipërme, burimi kryesor i financimit për buxhetin 12-mujor 2022 vijon të jetë nga të ardhurat e Bashkisë, në vlerën faktike 13,458,513,212 lekë e cila përbën 51% të të ardhurave totale faktike. Fondet e Pakushtëzuara dhe Sektoriale zënë 12% të burimeve të financimit të planifikuara, Fondet e Pakushtëzuara Rindërtimi zënë 24% të burimeve të financimit të planifikuara. Fondet e Kushtëzuara zënë 12% të strukturës së burimeve të financimit, sipas grafikut më poshtë:




#### 4.1 Donacione

Tabela e mëposhtme paraqet shpërndarjen e burimit Donator në bazë programesh:

Emertimi	Plan 2022	Plan 12M 2022	Fakti. 12M. 2022	% ndaj planit vjetor	struktura/ plani vjetor.
01110 Planifikim, Menaxhim & Administrim	25,412,067	25,412,067	5,852,880	23%	63%
03280 Mbrojtja nga Zjarri & Mbrojtja Civile	555,000	555,000	-	0%	1%
04160 Shërbimi i tregjeve, Akreditimi dhe Inspektimi	791,920	791,920	791,920	100%	2%
06260 Sherblimet Publike Vendore	263,191	263,191	-	0%	1%
08220 Trashëgimia Kulturore, Eventet Artistike & Kulturore	2,867,840	2,867,840	2,777,657	97%	7%
09120 Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor	9,076,515	9,076,515	4,064,995	45%	23%
09230 Arsimi i mesëm i përgjithshëm	500,344	500,344	-	0%	1%
10430 Kujdesi Social për familjet & fëmijet	821,714	821,714	551,143	67%	2%
<b>TOTAL</b>	<b>40,288,591</b>	<b>40,288,591</b>	<b>14,038,595</b>	<b>35%</b>	<b>100%</b>

## Donacionet sipas programeve



- Planifikim, Menaxhim & Administrim
- Shërbimi i tregjeve, akreditimi dhe inspektimi
- Trashegimia Kulturore, Eventet Artistike & Kulturore
- Arsimi baze perفشire arsimin parashkollor
- Kujdesi Social per familjet & femijet
- Të tjera

### 4.2 Financime të Huaja

Tabela e mëposhtme paraqet shpërndarjen e burimit Financimet e Huaja në bazë programesh:

Emertimi	Plan 2022	Fakti 2022	% ndaj planit vjetor	struktura/plani vjetor
<i>Projekte Zhvillimi</i>	159,129,121	-	0%	100%
<b>TOTAL</b>	<b>159,129,121</b>	-	<b>0%</b>	<b>100%</b>

### 5. Shpenzimet sipas klasifikimit në programe

Tabela më poshtë paraqet shpërndarjen e shpenzimeve të 12-mujorit 2022 në bazë programesh:

në lekë

Produkti 1: Mirëmbajtja e sipërfaqeve të shesheve të parkimit në total gjatë viti 2022 janë 51829 m<sup>2</sup> të cilat mirëmbahen nga institucioni i varësisë Tirana Parking. Buxheti i planifikuar për këtë vit është në vlerën 183,092,000 lekë, për këtë periudhë raportimi është realizuar në masën 82% të vlerës ose në vlerën 149,694,966 lekë.

Produkti 2: Mirëmbajtja e sistemeve të parkimeve dhe pastrimi, buxheti për vitin 2022 është në vlerën 18,228,000 lekë, për këtë periudhë raportimi është realizuar në masën 69% ose në vlerën 12,584,746 lekë.

## **12. Programi “Projekte Zhvillimi”**

Në këtë program përfshihen projekte që zhvillohen nga Aparati i Bashkisë.


Gjatë 12-mujorit 2022 për këtë funksion, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 32%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzime të tjera operative 74%
- Shpenzime kapitale 28%

në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2022	Plani 12M 2022	Fakti 12M 2022	Realizimi në %
<i>Shpenzime të tjera operative</i>	44,309,317	44,309,317	32,687,539	74%
<i>Shpenzime kapitale</i>	474,830,938	474,830,938	131,007,764	28%
<b>Totali</b>	<b>519,140,255</b>	<b>519,140,255</b>	<b>163,695,303</b>	<b>32%</b>

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si më poshtë:



Investimet për programin “Projektet e Zhvillimit” për vitin 2022 janë 25 projekte / investime që menaxhohen nga Aparati i Bashkisë që mbulon këtë funksion. Buxheti i planifikuar për këtë program është 474,830,938 lekë për vitin 2022, i cili është realizuar në masën 28% ose në vlerën 131,007,764 lekë.

### 13. Programi “Zhvillimi i Turizmit”

Në këtë program përfshihen projekte për zhvillimin e turizmit nga Aparati i Bashkisë.


Gjatë 12-mujorit 2022 për këtë funksion, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 100%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzime të tjera operative 100%

në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2022	Plani 12M 2022	Fakti 12M 2022	Realizimi në %
<i>Shpenzime të tjera operative</i>	20,152,950	20,152,950	20,152,950	100%
<b>Totali</b>	<b>20,152,950</b>	<b>20,152,950</b>	<b>20,152,950</b>	<b>100%</b>

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si më poshtë:



Për 12-mujorin 2022 vlen të përmenden Projekte Turizmi, buxheti i të cilës është planifikuar 20,152,950 lekë për 12-mujorin 2022, dhe është realizuar në vlerën 20,152,950 lekë, ose në masën 100% të periudhës së raportimit.

#### 14. Programi “Menaxhim i Mbetjeve”

Ky program menaxhohet nga Aparati i Bashkisë.


Realizimi i shpenzimeve për 12-mujorin 2022 për këtë funksion krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 96%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzime të tjera operative 96%

në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2022	Plani 12M 2022	Fakti 12M 2022	Realizimi në %
<i>Shpenzime të tjera operative</i>	2,502,533,554	2,502,533,554	2,392,484,863	96%
<b>Totali</b>	<b>2,502,533,554</b>	<b>2,502,533,554</b>	<b>2,392,484,863</b>	<b>96%</b>

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si më poshtë:



Për 12-mujorin 2022 vlen të përmenden këto produkte të programit të cilët zënë një peshë specifike në këtë funksion:

- Pastrimi i Qytetit, është planifikuar 1,629,543,356 lekë për 12-mujorin 2022, dhe është realizuar në vlerën 1,525,809,827 lekë, ose në masën 94% të planit 12-mujori të vitit 2022.
- Shpenzime për Ndërtimin e Landfillit, Inceneratorit dhe Rehabilitimit të vend-depozitimeve ekzistuese Tiranë dhe prodhimin e energjisë elektrike që është edhe në funksion të zhvillimit dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës vendore rajonale, është planifikuar 872,990,198 lekë për

12-mujorin 2022, dhe është realizuar në vlerën 866,675,036 lekë, ose në masën 99% të planit 12-mujor të vitit 2022.

### 15. Programi “Programet e Mbrojtjes së Mjedisit”

Ky program menaxhohet nga Aparati i Bashkisë.


Realizimi i shpenzimeve për 12-mujorin 2022 për këtë funksion, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 38%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzime të tjera operative 38%

në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2022	Plani 12M 2022	Fakti 12M 2022	Realizimi në %
<i>Shpenzime të tjera operative</i>	9,837,947	9,837,947	3,782,296	48%
<b>Totali</b>	<b>9,837,947</b>	<b>9,837,947</b>	<b>3,782,296</b>	<b>48%</b>

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si më poshtë:



Për 12-mujorin 2022 vlen të përmendet produkti i programit i cili zënë një peshë specifike në këtë funksion:

Hartimi i Planit të Veprimit mbi zhurmat për Bashkinë Tiranë, është planifikuar 3,837,947 lekë për 12-mujorin 2022, dhe është realizuar në vlerën 3,837,947 lekë, ose në masën 100% të planit 12-mujor të vitit 2022.

## 16. Programi “Planifikimi Urban Vendor”


Ky program menaxhohet nga Aparati i Bashkisë dhe Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit. Realizimi i shpenzimeve për 12-mujorin 2022, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 31%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet e personelit 92%
- Shpenzime të tjera operative 26%
- Shpenzime kapitale 28%

në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2022	Plani 12M 2022	Fakti 12M 2022	Realizimi në %
<i>Shpenzime personeli</i>	167,794,000	167,794,000	153,993,190	92%
<i>Shpenzime të tjera operative</i>	46,499,500	46,499,500	11,931,261	26%
<i>Shpenzime kapitale</i>	3,242,208,083	3,242,208,083	912,983,855	28%
<b>Totali</b>	<b>3,456,501,583</b>	<b>3,456,501,583</b>	<b>1,078,908,306</b>	<b>31%</b>

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si më poshtë:



Objekti 1 i këtij programi është: Harmonizimi i interesave publike dhe interesave private që do të rezultojë në mbrojtjen e hapësirave publike dhe atyre të gjelbërta; Planifikimin i objekteve të shpronësuara si rezultat i ndërtimit të veprave madhore nga Bashkia e Tiranës bazuar në legjislacionin

përkatës; Përmirësimin i cilësisë së shërbimeve për qytetarët; Hartimi i planeve të detajuara vendore për zbërthimin e planit të përgjithshëm vendor dhe kontrollit të zhvillimit të vazhdueshëm të hapësirave urbane të qytetit, duke bërë kështu që objekti i shpronësimit të jetë parësor në këtë program:

Investimet për programin e Planifikimit Urban Vendor për vitin 2022 janë 72 projekte / shpronësime dhe studime që menaxhohen nga Aparati i Bashkisë që mbulon këtë funksion nga të cilat janë realizuar 28 % të planit për këtë periudhë raportimi.

Objektivi 2 i këtij programi është: Inspektimi dhe kontrolli i subjekteve ndërtuese. Për arritjen e këtij objektivi, për 12-mujorin 2022, është realizuar produkti me të dhënat si vijon:

Produkti 1: Numri i inspektimeve tek të tretët (subjekte private dhe publike) për vitin 2022 janë planifikuar rreth 900 inspektime nga të cilat janë realizuar 486 inspektime për 12-mujorin e vitit 2022.

### 17. Programi “Programet e Zhvillimit”

Në këtë program përfshihen projekte që zhvillohen nga Aparati i Bashkisë.

Realizimi i shpenzimeve për 12-mujorin 2022 për këtë funksion, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 90%.


Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzime të tjera operative 78%
- Shpenzime kapitale 91%

në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2022	Plani 12M 2022	Fakti 12M 2022	Realizimi në %
<i>Shpenzime të tjera operative</i>	237,500,715	237,500,715	186,082,752	78%
<i>Shpenzime kapitale</i>	7,144,008,795	7,144,008,795	6,476,193,190	91%
<b>Totali</b>	<b>7,381,509,510</b>	<b>7,381,509,510</b>	<b>6,662,275,942</b>	<b>90%</b>





Objektivi i këtij programi është: Nxitja e bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë Tiranë dhe Asamblesë së Bashkëpronarëve për krijimin e një skeme efektive bashkë-financimi për përmirësimin e ambienteve në pronësi të përbashkët. Për 12-mujorin 2022 vlen të përmendet ky produkt i programit i cili zë një peshë specifike në këtë funksion:

Produkti 1: Projekti “Fondi i Komuniteteve, është planifikuar 84,165,715 lekë për 12-mujorin 2022, dhe është realizuar në vlerën 52,747,752 lekë, ose në masën 63% të planit 12-mujor të vitit 2022.

### 18. Programi “Shërbime Publike Vendore”

Në këtë program bëjnë pjesë institucionet e varësisë si më poshtë:

- Aparati i Bashkisë
- Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit
- Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit
- Agjencia e Shërbimeve Funerale

Realizimi i shpenzimeve për 12-mujorin 2022 për këtë funksion krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 49%.


Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzime personeli 88%
- Shpenzime të tjera operative 88%
- Shpenzime kapitale 36%

në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2022	Plani 12M 2022	Fakti 12M 2022	Realizimi në %
<i>Shpenzime personeli</i>	836,630,346	836,630,346	737,693,038	88%
<i>Shpenzime të tjera operative</i>	614,558,262	614,558,262	541,439,102	88%
<i>Shpenzime kapitale</i>	4,133,095,082	4,133,095,082	1,473,989,251	36%
<b>Totali</b>	<b>5,584,283,690</b>	<b>5,584,283,690</b>	<b>2,753,121,391</b>	<b>49%</b>

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si më poshtë:



Për 12-mujorin 2022 vlen të përmenden këto produkte të programit të cilët zënë një peshë specifike në këtë funksion:

- Investimet për programin e Shërbimeve Publike Vendore për vitin 2022 janë rreth 165 projekte / investime (ndërtim-montim; mbikqyrje; kolaudim; studim-projektim; oponencë teknike; të

tjera) që menaxhohen nga insitucionet që mbulojnë këtë funksion, realizuar në masën 36% për këtë periudhë raportimi.

Objektivi 1 i këtij programi është: Shtimi i ambienteve shlodhëse, argëtuese dhe terreneve sportive; Rikonstruksion i objekteve rekreative, sanitare, info-point, objekteve të shërbimit në parqe;

Rehabilitimi i sipërfaqeve të gjelbërta egzistuese. Për arritjen e këtij objektivi, për 12-mujorin 2022, janë realizuar produktet me të dhënat si vijon:

Produkti 1: Sipërfaqe e gjelbëruar në vit (zgjerimi i hapësirave të gjelbra) m<sup>2</sup> gjatë 12-mujorit janë shtuar 48,000 m<sup>2</sup> nga 48,000 m<sup>2</sup> të planifikuara për vitin 2022.

Produkti 2: Rrënjë peme të mbjella për 12-mujorin janë mbjellur 8,676 rrënjë nga 30,000 rrënjë të planifikuara për vitin 2022.

Produkti 3: Numri i punonjësve në shërbim të aktiviteteve, kënde lojrash rekreative dhe fushat sportive janë planifikuar për këtë vit 105 punonjës ose 65 punonjës më shumë se viti i kaluar. Ky numër është rritur nga shtimi i aktiviteteve në Tiranë, shtimi i këndeve të lojrave si dhe fushat sportive. Aktualisht, janë 105 punonjës, dhe si rezultat viti ka patur rritje nga plani fillestar. Për shkak të shtimit të shesheve rekreative është krijuar Drejtoria e Sporteve, Drejtoria e Zoo Parkut.

Objektivi 2 i këtij programi është: Administrimi dhe organizimi i shërbimeve funerale, pastrimi mirëmbajtja dhe ruajtja e varrezave publike. Për arritjen e këtij objektivi, për 12-mujorin 2022, është realizuar produkti me të dhënat si vijon:

Produkti 1: Sipërfaqe për mirëmbajtjen totale të varrezave në total janë 502,070 m<sup>2</sup>, sipërfaqe të cilat duhen të mirëmbahen gjatë viti 2022, buxheti i planifikuar për këtë produkt për vitin 2022 është 161,924.12 lekë, për këtë periudhë raportimi është realizuar në masën 82% ose 132,062.46 lekë.

## 19. Programi “Ndriçim Rrugësh”


Ky program menaxhohet nga Aparati i Bashkisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik.

Realizimi i shpenzimeve për 12-mujorin 2022, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 91%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzime të tjera operative 91%

në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2022	Plani 12M 2022	Fakti 12M 2022	Realizimi në %
<i>Shpenzime të tjera operative</i>	336,201,082	336,201,082	304,363,752	91%
<b>Totali</b>	<b>336,201,082</b>	<b>336,201,082</b>	<b>304,363,752</b>	<b>91%</b>



Objektivi i këtij programi është mirëmbajtja dhe ndriçimi i rrugëve dhe ambienteve publike në territorin e Bashkisë Tiranë. Për arritjen e këtij objekti, për 12-mujorin 2022, është realizuar produkti me të dhënat si vijon:

Produkti 1: Sheshe publike të ndriçuara janë planifikuar 7,072 m<sup>2</sup> sheshe për vitin 2022, për këtë periudhë raportimi sipërfaqja e shesheve të ndriçuara është 2,360 m<sup>2</sup>.

## 20. Programi “Sport dhe Argëtim”

Në këtë program bëjnë pjesë Aparati i Bashkisë dhe insitucionet e varësisë si më poshtë:


- Agjencia e Rinisë
- Klubi Sportiv “Tirana”
- Klubi shumësportësh “Partizani”
- Klubi Sportiv “Studenti”

Realizimi i shpenzimeve për 12-mujorin 2022, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 96%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- |                                |     |
|--------------------------------|-----|
| - Shpenzimet e personelit      | 91% |
| - Shpenzime të tjera operative | 97% |
| - Shpenzime kapitale           | 94% |

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2022	Plani 12M 2022	Fakti 12M 2022	Realizimi në %
Shpenzime personeli	73,371,653	73,371,653	67,070,620	91%
Shpenzime të tjera operative	663,697,410	663,697,410	646,434,462	97%
Shpenzime kapitale	121,715,598	121,715,598	114,657,003	94%
<b>Totali</b>	<b>858,784,661</b>	<b>858,784,661</b>	<b>828,162,085</b>	<b>96%</b>

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si më poshtë:



Ky program është në funksion të krijimit dhe mirëmbajtjes së hapësirave sportive dhe organizimit të aktiviteteve për rininë.

Për 12-mujorin 2022 vlen të përmenden këto produkte të programit të cilët zënë një peshë specifike në këtë funksion:

- Projekte Rinore janë planifikuar 15,791,700 lekë për 12-mujorin 2022 dhe është realizuar në vlerën 12,934,200 lekë, ose realizuar në masën 82 % të planit 12-mujor 2022.
- Projekte Sportive janë planifikuar 17,724,000 lekë për 12-mujorin 2022 dhe është realizuar në vlerën 17,487,077 lekë, ose në masën 99% të planit.
- Projekti “Tirana Youth Capital” është planifikuar 367,987,018.00 lekë për vitin 2022 dhe është realizuar në vlerën 367,987,018 lekë, ose realizuar në masën 100% të planit. Ky projekt paraqitet si një makro-program dhe mundësi fantastike që do të zgjasë 365 ditë, gjatë të cilave do i jepet jetë një kalendar projektesh me iniciativa e aktivitete të shumta, të cilat do të mbulojnë një gamë të gjerë tematikash e prioritetesh që kanë në qendër rininë, në nivel kombëtar, rajonal dhe europian.

- Projekti "Mbështetje financiare në kuader të aktivitetit ndërkombëtar Europa Conference League Final për Federatën Shqiptare të Futbollit" është planifikuar 27,926,500 lekë për 12-mujorin 2022 dhe është realizuar në vlerën 27,798,022 lekë, ose realizuar në masën 100% të planit 12-mujor 2022.
- Projekti "Akordim fondi për shpërblime për rekorde Kombëtare dhe kampionat Kombëtar për sportistë dhe trajnierë të nivelit të lartë është planifikuar 9,340,000 lekë për 12-mujorin 2022 dhe është realizuar në vlerën 9,340,000 lekë, ose realizuar në masën 100% të planit 12-mujor 2022.
- Investimet për programin "Sport dhe Argëtim" për vitin 2022 janë rreth 6 projekte / investime që menaxhohen nga insitucionet që mbulojnë këtë funksion të realizuara 94% gjatë kësaj periudhe raportimi.

## 21. Programi "Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore"

Në këtë program bëjnë pjesë Aparati i Bashkisë dhe Insitucionet e varësisë si më poshtë:


- Qendra Rinore TEN
- Qendra Kulturore Tirana
- Muzeu Vendor "Shtëpia Studio Kadare"
- Qendra e Restaurimit dhe Realizimit të Veprave të Artit Tiranë
- Muzeu Vendor "Shtëpia Studio Agolli"
- Galeria e Artit Tirana
- Agjensia e Industrisë Kreative

Realizimi i shpenzimeve për 12-mujorin 2022, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 83%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- |                                |     |
|--------------------------------|-----|
| - Shpenzimet e personelit      | 93% |
| - Shpenzime të tjera operative | 91% |
| - Shpenzime kapitale           | 21% |

në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2022	Plani 12M 2022	Fakti 12M 2022	Realizimi në %
<i>Shpenzime personeli</i>	108,096,683	108,096,683	100,735,192	93%
<i>Shpenzime të tjera operative</i>	613,205,000	613,205,000	557,407,565	91%
<i>Shpenzime kapitale</i>	96,260,556	96,260,556	20,345,814	21%
<b>Totali</b>	<b>817,562,239</b>	<b>817,562,239</b>	<b>678,488,571</b>	<b>83%</b>



Ky program është në funksion të krijimit, funksionimit dhe mirëmbajtjes së projekteve / ambienteve kulturore dhe artistike. Për 12-mujorin 2022 vlen të përmenden këto produkte të programit të cilët zënë një peshë specifike në këtë funksion:

- Projekte Kulturore janë planifikuar 283,728,252 lekë për 12-mujorin 2022 dhe është realizuar në vlerën 235,662,039 lekë, ose realizuar në masën 87% të planit të periudhës raportuese.
- Shërbimi i Dekorit të Qytetit, janë planifikuar 161,490,000 lekë për 12-mujorin 2022 dhe është realizuar në vlerën 154,795,102 lekë, ose realizuar në masën 96 % të planit 12-mujor 2022.
- Investimet për programin e Trashëgimisë Kulturore, Eventet artistike dhe kulturore për vitin 2022 janë rreth 33 projekte / investime që menaxhohen nga insitucionet që mbulojnë këtë funksion. Buxheti i planifikuar për këtë program është 96,260,556 lekë për vitin 2022, për të cilën realizimi është 21%.

Objektivi 1 i këtij programi është: Të organizojë sipas kalendarit festat e traditës, të ditëve kombëtare e ndërkombëtare, aktivitete derivate të binjakëzimeve si dhe të iniciojë aktivitete inovative masive dhe elitare duke evidentuar ndër to aktivitetet që do të jenë specifike për Tiranën. Për arritjen e këtij objektivi, për vitin 2022, janë realizuar produktet me të dhënat si vijon:

Produkti 1: Micro Folie Tirana, janë bërë në total 63 aktivitete ndër të cilat (aktivitete artistike dhe teknologjike, evente special, Workshop dedikuar vajzave “Beso tek ti”, etj), target grupi i këtyre aktiviteteve kanë qënë fëmijët dhe prindërit ku ka patur 2632 persona pjesëmarrës gjatë vitit 2022.

Produkti 2 : Aktivitete të cilat janë realizuar nga Agjencia Industrisë Kreative janë 63 aktivitete ku theksojmë aktivitete si ( Ekspozita e "Novelave Grafike nga Deti", Festivali i Muzikës Jazz, Fshati Krijues, Festa e Fërgës), me 10,622 pjesëmarrës gjatë vitit 2022.

Objektivi 2 i këtij programi është: Realizimi i veprave monumentale në skulpturë, plastike të parkut, zbukurime, dekoracione me rendësi për trashigiminë dhe zbukurimin e qytetit të Tiranës; Mirëmbajtjen, pastrimin dhe restaurimin e veprave ekzistuese në territorin e Bashkisë Tiranë. Për arritjen e këtij objektivi, për vitin 2022, është realizuar produkti me të dhënat si vijon:

Produkti 1: Mirëmbajtje dhe restaurim i veprave të artit me natyrë social-kulturore janë planifikuar 12,687,172 lekë për 12-mujorin 2022 dhe është realizuar në vlerën 12,015,081 lekë, ose realizuar në masën 95% të planit 12-mujor 2022

## 22. Programi “Arsimi Bazë përfshirë Arsimin Parashkollor”

Në këtë program bëjnë pjesë Aparati i Bashkisë dhe institucionet e varësisë si më poshtë:

- Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve,
- Shkolla “Luigj Gurakuqi”.


Realizimi i shpenzimeve për 12-mujorin 2022, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 75%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet e personelit 84%
- Shpenzime të tjera operative 83%
- Shpenzime kapitale 67%

në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2022	Plani 12M 2022	Fakti 12M 2022	Realizimi në %
<i>Shpenzime personeli</i>	1,535,484,863	1,535,484,863	1,289,575,430	84%
<i>Shpenzime të tjera operative</i>	690,319,817	690,319,817	570,358,604	83%
<i>Shpenzime kapitale</i>	2,346,472,585	2,346,472,585	1,565,971,591	67%
<b>Totali</b>	<b>4,572,277,265</b>	<b>4,572,277,265</b>	<b>3,425,905,625</b>	<b>75%</b>





Për 12-mujorin 2022 vlen të përmenden këto produkte të programit të cilët zënë një peshë specifike në këtë funksion:

- Investimet për programin e Arsimit Bazë përfshirë Arsimin Parashkollor për vitin 2022 janë rreth 72 projekte / investime (ndërtim-montim; mbikqyrje; kolaudim; studim-projektim; oponencë teknike; të tjera) që menaxhohen nga insitucionet që mbulojnë këtë funksion. Buxheti i planifikuar për investimet për këtë program është 2,346,472,585 lekë për vitin 2022, të cilat janë realizuar në vlerën 1,565,971,591 lekë ose në masën 67% të planit 12-mujor të vitit 2022.

Objektivi i këtij programi është: Trajtimi me mbështetje financiare për nxënësit që dalin me rezultate të shkëlqyera në shkollë. Për arritjen e këtij objekti, për vitin 2022, është realizuar produkti me të dhënat si vijon:

Produkti 1: Stimuli i nxënësve me dhjeta për t'u motivuar gjatë vitit 2022 është 115,227,000 lekë, për 12-mujorin 2022, dhe është realizuar në vlerën 99,798,000 lekë, ose në masën 87% të planit 12-mujor 2022.

### 23. Programi “Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm”


Në këtë program bëjnë pjesë Aparati i Bashkisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike

Realizimi i shpenzimeve për 12-mujorin 2022, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 77%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet e personelit 87%
- Shpenzime të tjera operative 91%

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2022	Plani 12M 2022	Fakti 12M 2022	në lekë
				Realizimi në %
<i>Shpenzime personeli</i>	- 624,639,487	624,639,487	542,163,654	87%
<i>Shpenzime të tjera operative</i>	576,150,751	576,150,751	525,301,525	91%
<i>Shpenzime kapitale</i>	795,927,576	795,927,576	476,571,807	60%
<b>Totali</b>	<b>1,996,717,814</b>	<b>1,996,717,814</b>	<b>1,544,036,986</b>	<b>77%</b>

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si më poshtë:



Për 12-mujorin 2022 vlen të përmenden këto produkte të programit të cilët zënë një peshë specifike në këtë funksion:

- Investimet për programin e Arsimit të mesëm të përgjithshëm për vitin 2022 janë rreth 46 projekte / investime (ndërtim-montim; mbikqyrje; kolaudim; studim-projektim; oponencë teknike; të tjera) që menaxhohen nga insitucionet që mbulojnë këtë funksion. Për këtë periudhë raportimi është realizuar në masën 60% të planit 12-mujor 2022.

Objektivi i këtij programi është: Mirëmbajtje e ambienteve në objektet arsimore parauniversitare mirëmbajtjen, lyerjen, pastrimin e grafitëve të paautorizuara, shkarravinave me përmbajtje anti-kulturore, figurave, reklamave apo ngjitjeve me materiale të ndryshme në sipërfaqet e mbikalimeve,

nëkalimeve përfshirë kolonat mbajtëse, muret rrethuese që përbëjnë pjesë të arkitekturës urbanistike, platformat ku janë vendosur monumente artistike, konstruksionet e shatërvaneve, si dhe çdo sipërfaqe tjetër ndërtimore e aksesit publik. Për arritjen e këtij objekti, për 12-mujorin 2022, janë realizuar produktet me të dhënat si vijon:

Produkti 1: Mirëmbajtje e objekteve arsimore para-universitare sipërfaqja totale për t'u mirëmbajtur gjatë vitit 2022 është 270,200 m<sup>2</sup>, buxheti i planifikuar për këtë produkt është në vlerën 401,100,900 lekë, për këtë periudhë raportimi janë mirëmbajtur 275,151 m<sup>2</sup> dhe është shpenzuar 402,021,000 lekë.

Produkti 2: Mirëmbajtje e objekteve arsimore para-shkollore sipërfaqja totale për t'u mirëmbajtur gjatë vitit 2022 është 50,181 m<sup>2</sup>, buxheti i planifikuar për këtë produkt është në vlerën 68,147,000 lekë, për këtë periudhë raportimi janë mirëmbajtur 49,241 m<sup>2</sup> dhe është shpenzuar 67,275,000 lekë.

Produkti 3: Mirëmbajtje e objekteve të tjera publike sipërfaqja totale për t'u mirëmbajtur gjatë vitit 2022 është 48,550 m<sup>2</sup>, buxheti i planifikuar për këtë produkt është në vlerën 62,701,180 lekë, për këtë periudhë raportimi janë mirëmbajtur 47,320 m<sup>2</sup> dhe është shpenzuar 63,325,000 lekë.

#### 24. Programi "Arsimi Profesional"


Në këtë program bën pjesë Drejtoria e Konvikteve të Shkollave të Mesme si institucion varësie.

Realizimi i shpenzimeve për 12-mujorin 2022, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 83%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet e personelit 78%
- Shpenzime të tjera operative 76%
- Shpenzime kapitale 97%

në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Planit 2022	Planit 12 M 2022	Fakti 12 2022	Realizimi në %
<i>Shpenzime personeli</i>	101,594,661	101,594,661	79,621,099	78%
<i>Shpenzime të tjera operative</i>	26,817,093	26,817,093	20,434,017	76%
<i>Shpenzime kapitale</i>	50,269,550	50,269,550	48,743,445	97%
<b><i>Totali</i></b>	<b>178,681,304</b>	<b>178,681,304</b>	<b>148,798,561</b>	<b>83%</b>



Objekivi i këtij programi është: Rritje e kapacitetit të nxënësve dhe përmirësimin të cilësisë së shërbimit të ofruar në konvikte. Për arritjen e këtij objekivi, për 12-mujorin 2022, është realizuar produkti me të dhënat si vijon:

Produkti: Numri i nxënësve të akomoduar në konvikte janë 245 nxënës për këtë 12-mujor të vitit 2022. Për këtë vit janë planifikuar të akomodohen 300 nxënës, buxheti i shpenzuar është në vlerën 100,055,116 lekë nga 128,411,754 lekë të planifikuar.

#### 25. Programi “Kujdesi Social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuar”


Ky program menaxhohet nga Aparati i Bashkisë.

Realizimi i shpenzimeve për 12-mujorin 2022, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 100%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzime të tjera operative 100%

në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2022	Plani 12M 2022	Fakti 12M 2022	Realizimi në %
<i>Shpenzime të tjera operative</i>	17,721,576	17,721,576	17,636,276	100%
<b>Totali</b>	<b>17,721,576</b>	<b>17,721,576</b>	<b>17,636,276</b>	<b>100%</b>



Objektivi për këtë program është: Përfitime monetare ose në natyrë për personat që janë plotësisht ose pjesërisht të paaftë të merren me veprimtari ekonomike ose të bëjnë një jetë normale për shkak të një gjymtimi fizik ose mendor. Për arritjen e këtij objekti, për 12-mujorin 2022, është realizuar produkti me të dhënat si vijon:

Produkti 1: Projekti “Komisione për pagesa NE+PAK” janë planifikuar 17,070,000 lekë për 12-mujorin 2022, dhe është realizuar në vlerën 16,984,700 lekë, ose në masën 100% të planit 12-mujor 2022.

## 26. Programi “Kujdesi social për familjet dhe fëmijët”

Në këtë program bëjnë pjesë Aparati i Bashkisë dhe institucionet e varësisë si më poshtë:

- Qendra Sociale Multidisiplinare
- Qendra Komunitare “Shkozë”
- Qendra Komunitare “Të qëndrojmë së bashku”
- Qendra Komunitare “Strehëza”
- Qendra Komunitare “Gonxhe Bojaxhiu”
- Qendra Komunitare e Terrenit


Realizimi i shpenzimeve për 12-mujorin 2022, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 65%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet e personelit 85%
- Shpenzime të tjera operative 48%
- Shpenzime kapitale 84%

në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2022	Plani 12M 2022	Fakti 12M 2022	Realizimi në %
<i>Shpenzime personeli</i>	130,451,206	130,451,206	111,160,881	85%
<i>Shpenzime të tjera operative</i>	164,920,233	164,920,233	78,851,490	48%
<i>Shpenzime kapitale</i>	7,098,459	7,098,459	5,928,664	84%
<b>Totali</b>	<b>302,469,898</b>	<b>302,469,898</b>	<b>195,941,035</b>	<b>65%</b>

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si më poshtë:



Për 12-mujorin 2022 vlen të përmenden këto produkte të programit të cilët zënë një peshë specifike në këtë funksion:

- Projekti “Mbështetje Sociale në Shërbime për kategoritë në nevojë” janë planifikuar 27,053,014 lekë për 12-mujorin 2022 dhe është realizuar në vlerën 970,002 lekë, ose në masën 4% të planit të periudhës së raportimit.
- Ndihma Ekonomike / Paaftësia janë planifikuar 281,738,000 lekë për buxhetin e vitit 2022, dhe është realizuar në vlerën 281,710,235 lekë, ose në masën 100% të planit (transferata e kushtëzuar).

- Projekti “Mbrojtja Sociale për kategorinë e familjeve në nevojë të përjashtuara nga skema e NE-së” janë planifikuar 8,700,000.00 lekë për 12-mujorin 2022 dhe është realizuar në vlerën 7,320,348 lekë, ose në masën 84% të planit të periudhës së raportimit.
- Investimet për programin e Kujdesit Social për Familjet dhe Fëmijët për vitin 2022 janë 19 projekte / investime që menaxhohen nga institucionet që mbulojnë këtë funksion dhe janë realizuar në masën 84% të planit 12-mujor të vitit 2022.

Objekti për këtë program është: Mbështetje sociale, psiko-mediko-emocionale, ligjore, edukative për fëmijët dhe familjet në nevojë, të komuniteteve të ndryshme, shërbimin e mencës, aktivitete të ndryshme për të gjithë llojet e shtresave në nevojë. Për arritjen e këtij objekti, për 12-mujorin 2022, janë realizuar produktet me të dhënat si vijon:

Produkti 1: Përfshirja e fëmijëve dhe të rinjve në kamp veror me qëllim zhvillimin e aftësive për jetën dhe parandalimin e sjelljeve të rrezikshme. Shërbimi aktualisht ju ofrohet 50 personave. Buxheti i planifikuar për këtë vit është në vlerën 530,238 lekë për të cilat janë shpenzuar 89% e vlerës. Nga viti i kaluar kemi një rritje me 25% të fëmijëve dhe të rinjve që ofrohet ky shërbim.

Produkti 2: Numri i personave në situatë rruge të trajtuara janë 437 persona (fëmijë dhe të rritur) buxheti i planifikuar 4,634,283 lekë nga të cilat janë shpenzuar 4,102,803 lekë për këtë periudhë raportimi.

Produkti 3: Numri i fëmijëve dhe të rinjve me aftësi të kufizuar që përfitojnë të gjitha shërbimet ditore pa përfshirë mencën për vitin 2022 është planifikuar t’ju ofrohet 60 personave nga të cilët për këtë periudhë raportimi e kanë marrë si shërbim 25 persona.

## 27. Programi “Papunësia, Arsim dhe Aftësim Profesional”


Në këtë program përfshihen projekte që zhvillohen nga Aparati i Bashkisë.

Realizimi i shpenzimeve për 12-mujorin 2022, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 67%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzime të tjera operative 67%

në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2022	Plani 12M 2022	Fakti 12M 2022	Realizimi në %
<i>Shpenzime të tjera operative</i>	35,000,000	35,000,000	23,500,000	67%
<b>Totali</b>	<b>35,000,000</b>	<b>35,000,000</b>	<b>23,500,000</b>	<b>67%</b>



Objektivi 1 i këtij programi është: Fuqizimi ekonomik i grave dhe të rejave të cilat me hapjen dhe zgjerimin e bizneseve të vogla nëpërmjet granteve, zgjedhin të zhvillojnë idetë e tyre inovatore në biznes që gjenerojnë vetëpunësim dhe rritjen e numrit të të punësuarve. Për arritjen e këtij objekti, për 12-mujorin 2022, janë realizuar produktet me të dhënat si vijon:

Produkti 1: Projekti “Fuqizimi i grave dhe nxitja e sipërmarrjes”, është planifikuar 20,000,000 lekë për 12-mujorin 2022, dhe është realizuar në vlerën 9,500,000 lekë.

Objektivi 2 është: Krijimi i lehtësirave për hapjen e vendeve të reja të punës për të rinj të sapo diplomuar pa eksperiencë pune të cilët kanë pritshmëri punësimi dhe integrimi në tregun e punës; Nxitjen e punësimit të biznesit rinor, nëpërmjet lehtësirave në ngritjen e biznesit të vogël. Për arritjen e këtij objekti, për 12-mujorin 2022, janë realizuar produktet me të dhënat si vijon:

Produkti 1: Projekti “Projekti i fuqizimit të të rinjve dhe të rejave”, është planifikuar 15,000,000 lekë për 12-mujorin 2022, dhe është realizuar në vlerën 14,000,000 lekë për këtë periudhë raportimi.

## 28. Programi “Strehimi Social”

Ky program menaxhohet nga Aparati i Bashkisë.

Realizimi i shpenzimeve për 12-mujorin 2022, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 22%.




Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzime të tjera operative 87%
- Shpenzime kapitale 0%

në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2022	Plani 12M 2022	Fakti 12M 2022	Realizimi në %
<i>Shpenzime të tjera operative</i>	358,899,573	358,899,573	313,285,081	87%
<i>Shpenzime kapitale</i>	1,086,847,184	1,086,847,184	-	0%
<b>Totali</b>	<b>1,275,746,757</b>	<b>1,275,746,757</b>	<b>161,455,991</b>	<b>22%</b>

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si më poshtë:



Objekti i programeve sociale të strehimit është përcaktimi i rregullave dhe procedurave administrative për mënyrat e planifikimit, sigurimit, administrimit dhe të shpërndarjes së programeve sociale për strehimin, me qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përballueshëm, duke u mbështetur në aftësitë paguese të familjeve që kanë nevojë për strehim dhe në ndihmën e institucioneve shtetërore përgjegjëse. Për arritjen e këtij objekti, për 12-mujorin 2022, janë realizuar produktet me të dhënat si vijon:

Produkti 1: Projekti “Bonus Strehimi”, është planifikuar 275,000,000 lekë për 12-mujorin 2022, dhe është realizuar në vlerën 255,521,911 lekë, ose në masën 93% të planit 12-mujor të vitit 2022.

Produkti 2: Projekti "Bonus Strehimi për trajtimin me pagesë të qirasë për familjet që preken nga zbatimi i projektit të rehabilitimit të segmentit Komuna e Parisit-Rr.Kavajës, është planifikuar në vlerën 13,999,206 lekë për 12-mujorin 2022, dhe është realizuar në vlerën 12,226,716 lekë.

Produkti 3: Bonus Strehimi për trajtimin me pagesë të qirasë (në kuadër të rindërtimit) për familjet që preken nga zbatimi i projektit "Rehabilitimi i lagjes 5 Maji", është planifikuar në vlerën 20,000,000 lekë për 12-mujorin 2022, dhe është realizuar në vlerën 11,692,000 lekë.

Produkti 4: Bonus Strehimi për trajtimin me pagesë të qirasë (në kuadër të rindërtimit) për familjet që preken nga zbatimi i projektit "Rindërtimi në Kombinat" është planifikuar në vlerën 33,000,000.00 lekë për 12-mujorin 2022, dhe është realizuar në vlerën 29,940,000 lekë.

# KAPITULLI IV

## ECURIA

### E


## BUXHETIT TË BASHKISË TIRANË PËR VITET 2018-2022

Trendi i kryerjes së shpenzimeve të buxhetit ndër vite paraqitet si më poshtë, në bazë të klasifikimit ekonomik dhe me të gjitha burimet e financimit në Bashkinë Tiranë:

000/ lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Fakti 12M 2018	Fakti 12M 2019	Fakti 12M 2020	Fakti 12M 2021	Fakti 12M 2022
<i>Shpenzime personeli</i>	4,782,499	5,096,092	5,376,809	6,026,363	6,164,001
<i>Shpenzime të tjera operative</i>	8,275,541	9,330,864	11,779,539	12,405,906	13,192,178
<i>Shpenzime kapitale</i>	6,753,919	7,349,201	7,365,317	10,064,981	12,755,057
<b>Totali</b>	<b>19,811,958</b>	<b>21,776,156</b>	<b>24,521,665</b>	<b>28,497,249</b>	<b>32,111,236</b>

Si dhe paraqitjen grafike të tyre:



# Klasifikimi i shpenzimeve sipas burimeve të financimit vitet 2018 - 2022

000/ lekë

Shpenzimet sipas burimeve te financimit	Fakti 12M 2018	Fakti 12M 2019	Fakti 12M 2020	Fakti 12M 2021	Fakti 12M 2022
<i>Të ardhura BT</i>	12,004,596	14,399,421	14,764,406	12,683,980	13,458,513
<i>Transferta e Pakushtëzuar</i>	3,033,269	3,973,627	3,345,124	3,187,913	4,335,767
<i>Transferta e Pakushtëzuar /Rindërtimi</i>			2,154,087	8,544,773	9,382,669
<i>Transferta e Kushtëzuar</i>	4,774,093	3,403,108	4,200,855	4,027,311	4,910,941
<i>Donacione</i>			57,143	50,158	14,039
<i>Financimet e Huaja</i>				3,115	
<i>TVSH Detyrimi</i>					9,308
<b>Totali</b>	<b>19,811,958</b>	<b>21,776,156</b>	<b>24,521,614</b>	<b>28,497,249</b>	<b>32,111,236</b>

Si dhe paraqitjen grafike të tyre:

